



# Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Ftesë për Ofertë

Data: 05 shtator 2025

Titulli: Vazhdimi i afatit për aplikim - Ftesë për të dorëzuar ofertë për shërbime të akomodimit, ushqimit dhe sallës së konferencës në Bashkinë e Durrësit

Të nderuar,

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) kërkon ofertë për akomodimin e një grupi prej afërsisht **120 personash** në Durrës, për periudhën **26–28 Shtator 2025** (2 netë), me shërbim **Full Board** dhe me sallë konference. Ju lutemi na dërgoni ofertën tuaj më të mirë, e cila duhet të përmbajë të gjitha elementet sipas specifikimeve më poshtë:

### Akomodimi:

- 10 dhoma teke (single)
- 45-50 dhoma dyshe (twin, me dy shtretër të ndarë)
- 5-10 dhoma me qasje e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara (hyrje, ashensorë, dhoma, tualete, qasje në sallë konference)

### Ushqimi (Full Board):

- Dita 1 (26 Shtator): Drekë dhe darkë
- Dita 2 (27 Shtator): Mëngjes, drekë, darkë
- Dita 3 (28 Shtator): Mëngjes
- Dy pushime për kafe për ditën e plotë të konferencës (27 Shtator)
- Ushqimi duhet të përfshijë opsionet për ushqim vegetarian, vegan, pa gluten, halal, etj.

### Salla e konferencës:

- Kapacitet: minimum 120 persona (teatër) për pasditen dhe mbrëmjen e 26 Shtator dhe gjithë ditën e 27 Shtator
- Pajisje (opcionale: ju lutem, tregoni nëse është e disponueshme dhe koston për secilën): projektor, ekran, sistem audio, 2–4 mikrofona wireless dore, 2 mikrofona me lidhje në jakë, foltore, internet Wi-Fi për të gjithë pjesëmarrësit, ujë për folësit, tavolinë për shënime në fund të sallës
- Sallë ndihmëse (breakout room): opcionale – të specifikohet kapaciteti dhe kostoja për 0.5 ditë më 27 Shtator

Ju ftojme të paraqisni ofertën tuaj në përputhje me dosjen e tenderit të bashkëngjitur. Oferta duhet të përmbajë: (1) Ofertë me shkrim (Forma 5.1), (2) Ofertë Financiare (Forma 5.2), dhe (3) Letër motivimi dhe Deklaratë Nderi (Forma 4).

Ju lutem, dërgoni ofertën tuaj në: [procurement@womensnetwork.org](mailto:procurement@womensnetwork.org) me titull: “Oferta – Hotel & Konferencë”. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **09 Shtator, 2025**. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren parasysh.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

